



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Mirëqenies Sociale 2016





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Mirëqenies Sociale 2016



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Prill, 2017
© : Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet <http://ask.rks-gov.net/>

P a r a t h ë n i e

Publikimi “Statistikat e Mirëqenies Sociale 2016” përmban të dhëna për: skemën e ndihmës sociale, pensionet bazë, pensionet kontributpaguese, pensionet e personave me aftësi të kufizuara, skemën për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranët e luftës, skemën e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), skemën e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), skemën e pensioneve të Minatorëve të Trepçës, skemën për personat e verbër, të dhënat për numrin e fëmijëve të braktisur, numrin e personave të vendosur në shtëpitë për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, numrin e personave me aftësi të kufizuara të vendosur në institutin special të Shtimes si dhe në shtëpitë e komunitetit.

Burim i këtyre të dhënave është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përkatësisht departamentet në vijim: Departamenti i Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale dhe Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFDIL), të cilët i falënderojmë për bashkëpunim.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim mund t'i dërgoni në adresën elektronike social@rks-gov.net.

Publikimin përgatitën:

Avni Kastrati– u.d .Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Naime Rexhepi – Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave Sociale
Zyrtar për dizajn: Ahmet Cakolli

Prill 2017

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK–së,
Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MPMS	-	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DFDIL	-	Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës
PPAK	-	Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara
SHPMPF	-	Shtëpitë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare
ISSH	-	Instituti Special i Shtimes
TMK	-	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
FSK	-	Forcat e Sigurisë së Kosovës

Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
-	-	Nuk ka dukuri

Përmbajtja

Faqe

Tabela 1. Skema e ndihmës sociale sipas komunave	13
Tabela 2 .Skema e ndihmës sociale 2015 / 2016	14
Tabela 3. Pensionet bazike të moshës sipas komunave	15
Tabela 4. Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit	16
Tabela 5. Pensionet bazike të moshës në vitet 2015 / 2016	17
Tabela 6. Pensionet kontributpaguese të moshës sipas komunave	19
Tabela 7. Pensionet kontributpaguese të moshës sipas nacionalitetit	21
Tabela 8. Pensionet kontributpaguese të moshës në vitet 2015 / 2016	22
Tabela 9. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas komunave	23
Tabela 10. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas nacionalitetit	24
Tabela 11. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara në vitet 2015 / 2016	25
Tabela 12. Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara sipas komunave dhe gjinisë (0-18 vjeç	27
Tabela 13. Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara në vitet 2015 / 2016	28
Tabela 14. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas komunave	30
Tabela 15. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas moshës	31
Tabela 16. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas kategorive	31
Tabela 17. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas nacionalitetit	32
Tabela 18. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës në vitet 2015 / 2016	33
Tabela 19. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas komunave	34
Tabela 20. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas moshës	35
Tabela 21. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas kategorive	35
Tabela 22. Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas nacionalitetit	36
Tabela 23. Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) sipas komunave	37
Tabela 24. Skema e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) sipas komunave	38
Tabela 25. Skema e pensioneve të Minatorëve të Trepçës sipas komunave	39
Tabela 26. Skema e kompensimeve për personat e verbër sipas komunave	40
Tabela 27. Fëmijët e braktisur sipas komunave	41
Tabela 28. Fëmijët e braktisur në vitet 2015 / 2016	42
Tabela 29. Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare sipas nacionalitetit të vendosur në SHPMPF në Prishtinë dhe në shtëpitë e komunitetit	43
Tabela 30. Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare sipas gjinisë të vendosur në SHPMPF në Prishtinë dhe në shtëpitë e komunitetit	44
Tabela 31. Personat e vendosur në SHPMPF në Prishtinë dhe në shtëpitë e komunitetit sipas viteve 2015 / 2016	45
Grafikoni 20. Personat e vendosur në SHPMPF në Prishtinë dhe në shtëpitë e komunitetit sipas viteve 2015 / 2016	46

Faqe

Tabela 32. Personat e vendosur në Institutin e Shtimes dhe shtëpitë e komunitetit sipas nacionalitetit	46
Tabela 33. Personat e vendosur në Institutin Special të Shtimes dhe në shtëpitë e komunitetit sipas gjinisë	47
Tabela 34. Personat e vendosur në Institutin Special të Shtimes (ISSH) dhe në shtëpitë e komunitetit në vitet 2015 / 2016	48

Shpjegime për shfrytëzuesit

Pensionet¹

Pensioni bazik i moshës – pensioni minimal i rregullt mujor të paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, pa marrë parasysh, a kanë qenë të punësuar apo jo dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj; Pensioni bazik i moshës iu paguhet të gjithë personave që janë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës, të cilët posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare. Shuma mujore e këtij pensioni është 75€.

Pension kontributpagues i moshës- është pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare KSAK-së nr. 26/83) e të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj. Përgjatë, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale.

Shuma e pensionit kontributpagues të moshës nga muaji janar 2016 ka pësuar ndryshime ku pensionet paguhen sipas kategorizimeve në bazë të nivelit të shkollimit si në vijim :

Kategoria e parë-pensionist i pa arsimuar ose me arsim fillor –shuma e pensionit është 158 euro;

Kategoria e dytë –pensionist me arsim të mesëm- shuma e pensionit është 172 euro;

Kategoria e tretë –pensionist me arsim të lartë - shuma e pensionit është 186 euro;

Kategoria e katër –pensionist me arsim universitar- shuma e pensionit është 230 euro.

¹Definicionet për pensionet bazike të moshës , pensionet kontributpaguese të moshës , pensionet e personave me paafësi të përhershme dhe pensionet e parakohshme të Trepçës janë marrë nga Ligji Nr.04-L-131

Pensionet e personave me aftësi të kufizuara – pensioni i paaftësisë së përhershme iu ofron mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me ligjin nr. 04/L-131 sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Pensionin e paaftësisë së përhershme iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë(65) vjeç. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës te parashtruesi i kërkesës dhe vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë(5) vitesh. Pas skadimit të afateve të përcaktuara personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor. Ministria apo Autoriteti përkatës mund t'i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar. Shuma mujore e këtij pensioni është 75€.

Pensionet e Trepçës – Të drejtën në pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça” të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004. Pensionet iu paguhen të gjithë minatorëve të kompleksit “Trepça” nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm sipas Ligjit mbi skemat pensionale të financuara nga shteti (Ligji nr.04-L-31). Shuma mujore e pagesës është 105 €.

Pensionet e Trupave mbrojtëse të Kosovës (TMK)-pension i rregullt i TMK-së është pagesa e rregullt mujore që i bëhet ish-pjesëtarit të TMK-së gjatë tërë jetës. Po ashtu përfitues nga ky pension janë trashëgimtarët- të afërmit e varur të pensionistëve të TMK-së pas vdekjes së pensionistit si bashkëshortët, fëmijët e pensionistit të TMK-së që në kohën e vdekjes së tij –saj janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Shuma e pagesës së pensioneve të TMK-së përcaktohet prej 50%, 60% dhe 70% të pagës mesatare për 3(tri) vitet e fundit.

Pension i Forcave të Sigurisë së Kosovës- është pagesa e rregullt mujore që i paguhet pjesëtarit të FSK-së i cili i plotëson kriteret e parapara në Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (Ligji nr.04/L-084).Përfituesit kanë të drejtë në pensionin e FSK-së, pavarësisht nga një punësim tjetër në sektorin publik ose privat, përveç nëse ata shërbejnë sërish në FSK. Po ashtu përfitues nga ky pension pas vdekjes së pensionistit edhe bashkëshorti-ja ,fëmijët trashëgimtarë, duke përfshirë fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar dhe prindërve të pensionistit nëse pensionisti nuk ka bashkëshort-e dhe fëmijë.

Shuma e pagesës së pensioneve të FSK-së përcaktohet prej 50%, 60% dhe 70% të pagës mesatare për 3(tri) vitet e fundit.

Kompensimet për personat e verbër - /E verbër konsiderohet personi me humbje të plotë të të pamurit të lindur ose të fituar të përcaktuar sipas kriterëve mjekësore të vlerësuara nga Komisioni Mediko-social. Komisioni Mediko-social është komisioni i përbërë prej ekspertëve mjekësor dhe social ,i formuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili bën përcaktimin e shkallës së verbërisë, duke përfshirë kohëzgjatjen e saj, për secilin person që paraqet kërkesë për të gëzuar kompensim për shkak të verbërisë, përfitimet dhe të drejtat sipas ligjit 04/L-092. Këto pagesa bëhen çdo muaj nga Departamenti i Administratës Pensionale. Përfitimin material për shkak të verbërisë e marrin personat, pavarësisht nga mosha dhe në të njëjtën masë përfitojnë edhe shoqëruesit e të verbërve të grupit të parë, nevoja për të cilët përcaktohet nga Komisioni Mediko-social. E drejta në përfitim material të verbërisë për personat e verbër, si dhe shoqëruesit e tyre realizohet nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet dhe kriteret për realizimin e tyre të përcaktuara në Ligjin nr.04/L-092.

Shuma e pagesës për personat e verbër është 125€ në muaj si dhe 125€ për shoqëruesit e personave të verbër.

Familjet e dëshmorëve dhe Invalidët e luftës²

Dëshmor i kombit- është luftëtari i UÇK-së që:

- ka rënë në luftë për lirinë e vendit;
- është plagosur në luftë për lirinë e vendit dhe ka vdekur si pasojë e plagëve të marra brenda tri (3) viteve pas përfundimit të luftës.

Invalid i luftës së UÇK-së – është luftëtari , pjesëtari dhe i internuari (burgosuri) i UÇK-së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku 10%. Invalidët me kujdestar (Invalidi i UÇK-së me shkallë të invaliditetit mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër).

Veteran i luftës i UÇK-së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës.

Shuma e pagesës mujore për të gjitha kategoritë e skemës së DFDIL është si në vijim:

² Definicioni për invalidët e luftës dhe vetranët është marr në Ligjin Nr.04/L-172

Kategoritë	Shuma e pensionit
Familjet e Dëshmorëve	
Familja që e ka dhënë një Dëshmor:	448,13 €
Familja që i ka dhënë dy Dëshmorë:	537,76 €
Familja që i ka dhënë tre Dëshmorë:	582,57 €
Familja që i ka dhënë katër Dëshmorë:	627,39 €
Familja që i ka dhënë me shumë se 4 Dëshmorë:	672,19 €
Familjet e të zhdukurve të UÇK-së	448,13 €
Familja me një të zhdukur të UÇK-së	537,76 €
Familja me dy të zhdukur të UÇK-së	582,57 €
Familja me tre të zhdukur të UÇK-së	627,39 €
Familja me katër të zhdukur të UÇK-së	672,19 €
Familja me më shumë se 4 të zhdukur të UÇK-së	
Invalidët e Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	448,13 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	412,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	393,75 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	375,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	356,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	318,75 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	225,00 €

Invalidi me kujdestar

Kujdestari për Invalidin me dëmtim trupor me mbi 80%	225,00 €
--	----------

Familjet e Invalidëve të Luftës pas vdekjes

Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	358,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	330,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	315,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	300,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	285,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	255,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	180,00 €

Familjet e Viktimave dhe të Zhdukurve Civil

Familja e Viktimës -të Zhdukurit Civil	168,75 €
Familja me dy Viktima - të Zhdukur	202,50 €
Familja me tre Viktima - të Zhdukur	219,38 €
Familja me katër Viktima - të Zhdukur	236,25 €
Familja me katër e më shumë Viktima -të Zhdukur	253,13 €

Invalidët Civil të Luftës

Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	152,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	136,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	120,00 €

Invalidi me kujdestar

Kujdestari për Invalidin me dëmtim trupor me mbi 80%	50,13 €
--	---------

Familjet e Invalidëve Civil të Luftës pas vdekjes

Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	123,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	110,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	97,25 €

Veteranët

Veteranët Luftëtar	170,00 €
Familja e Veteranit pas vdekjes së Veteranit	119,00 €

Fëmijët e braktisur³

Fëmijë i braktisur pa kujdes prindëror, konsiderohet çdo fëmijë i moshës nën 18 vjeç, i cili është i braktisur nga prindërit, të cilët për shkaqe dhe arsye të ndryshme nuk i kryejnë, apo nuk janë në gjendje ti kryejnë obligimet, përgjegjësitë dhe të drejtat prindërore. Format e mbrojtjes për këtë kategori të fëmijëve janë: kujdestaria, bashkimi familjar, strehimi familjar, strehimi i përkohshëm institucional dhe adoptimi.

Shtëpia e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare (SHPMF) në Prishtinë dhe shtëpitë me bazë në komunitet (SHBK) –Për ta fituar të drejtën për vendosje në SHPMF dhe SHBK parashtuesi i kërkesës duhet t'i plotësojë këto kritere themelore: të jetë banorë i përhershëm i Republikës së Kosovës , të jetë mbi moshën 65 vjeçare, të mos ketë fëmijë biologjik apo të birësuar (vendosja –strehimi nuk pengohet nëse klienti në gjendje të nevojës ka vajzë e cila është e martuar), të jetë në gjendje të mirë psikike, të mos ketë sëmundje infektive. SHPMF dhe SHBK ofrojnë këto shërbime: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës dhe shërbime fizioterapeutike.

Instituti Special i Shtimes dhe me shtëpitë bazë me komunitet – ofrojnë këto shërbime për rezidentët :ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës, edukative dhe aftësuese, trajtim social dhe terapi fizikale. Përfitues të këtyre shërbimeve janë personat me aftësi të kufizuara mendore (ngecje në zhvillimin mendor), fizike dhe të kombinuara, të cilët jetojnë të vetëm, kanë anëtarë të ngushtë të familjes, por për arsye të ndryshme janë të penguar të ofrojnë përkujdesje për anëtarin e familjes në gjendje të nevojës sociale.

Skema për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara⁴ “Përkrahje materiale” është beneficion në formë të shumës financiare mujore ose formë tjetër e shpërblimit në të holla që administrohet nga MPMS-ja , për familje me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme “Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore dhe shqisore” konsiderohen fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër. Ndihma materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, do të ofrohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Departamentit të saj të Mirëqenies Sociale. Ndihma materiale mundëson fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme të bëjnë një jetë më normale në kushtet që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë jetën e tyre. Ndihma materiale për fëmijën e me aftësi të kufizuar të përhershme paguhet në emër të prindit apo kujdestarit të fëmijës, përmes xhironlogarisë bankare.

³ Definicioni për fëmijët e braktisur është marrë në Ligjin mbi familjen dhe marrëdhëniet e familjes nr. 10/84

⁴ Definicioni për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme është marrë në Ligjin nr. 03/L-022

Ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore u takon fëmijëve më aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Kosovës dhe janë me aftësi të kufizuar të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh.

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

- a) fëmijët e palëvizshëm,
- b) fëmijët plotësisht të verbër si dhe,
- c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vet, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale. Shuma mujore e pagesës është 100€.

Skema e ndihmës sociale⁵

Skema e ndihmës sociale ofron ndihmë të përkohshme financiare familjeve të cilat janë në varfëri dhe janë të përzgjedhura në përputhje me kriteret e parapara në ligj dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Kosovës.

Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive të përcaktuara me ligj. Përjashtimisht, shfrytëzues të ndihmës sociale, mund të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët: kanë leje qëndrimi në Kosovë, personat në cilësinë e azilkërkuarit, personat në cilësinë e refugjatit dhe personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese.

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë më poshtë të person i/e varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

Person i/e varur – përkufizohet si individ i cili i takon njërit prej grupeve që vijojnë: personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç (18 vjeç) dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara që e bëjnë atë të pa aftë për të punuar për punë shpërblyese, personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar, kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi të kufizuara apo të personave në moshën 65 vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeç, personat deri në moshën 14 vjeç, personat ndërmjet moshave 15 dhe 18 vjeç dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm, prindërit vetushqyes me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.

⁵ Definicioni për skemën e ndihmës sociale është marrë nga: Ligji nr.04/L-096

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë (i cili duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në Zyrën e Punësimit) dhe me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

Familjet që konsiderojnë se janë rast social sipas kategorisë së parë dhe të dytë i parashtrojnë kërkesë me shkrim për ndihmë sociale organit përkatës-Qendrave për Punë Sociale në komuna.

Familja e përzgjedhur për skemën e ndihmës sociale, për çdo fëmijë të moshës (0) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, realizon një përfitim financiar prej 5 euro në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimit dhe përmirësimit të shëndetit.

Familja që fiton të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë do të marr ndihmë sociale deri në dymbëdhjetë (12)muaj.

Familja që fiton të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë do të marr ndihmë sociale deri në gjashtë (6)muaj.

Pas kalimit të afatit të periudhës prej një (1) viti, përkatësisht, gjashtë (6) muaj, familja duhet të bëjë kërkesë të re për vazhdimin e të drejtës për ndihmë sociale.

Nga muaji nëntor 2015 ,shuma e pagesës së ndihmës sociale është rritur për 25%.

Shuma mujore e ndihmës sociale e cila iu paguhet familjeve në varfëri ndryshon, sa më i madh që të jetë numri i anëtarëve të familjeve si në vijim:

Familjet sipas numrit të anëtarëve	Shuma në €
Familja me një (1) anëtarë	50,00
Familja me dy (2) anëtarë	68,75
Familja me tre (3) anëtarë	75,00
Familja me katër (4) anëtarë	81,25
Familja me pesë (5) anëtarë	87,50
Familja me gjashtë (6) anëtarë	93,75
Familja me shtatë (7) anëtarë	100,00
Familja me tetë (8) anëtarë	106,25
Familja me nëntë (9) anëtarë	112,50
Familja me dhjetë (10) anëtarë	118,75
Familja me njëmbëdhjete(11) anëtarë	125,00
Familja me dymbëdhjetë (12) anëtarë	131,25
Familja me trembëdhjetë (13) anëtarë	137,50
Familja me katërbëdhjetë (14) anëtarë	143,75
Familja me pesëmbëdhjetë (15) anëtarë	150,00

Tabela 1. Skema e ndihmës sociale sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3			TM4		
	Familje	Anëtarë	Anëtarë/ Familje	Familje	Anëtarë	Anëtarë/ Familje	Familje	Anëtarë	Anëtarë/ Familje	Familje	Anëtarë	Anëtarë/ Familje
Deçan	478	1.963	4,11	480	1.961	4,09	403	1.606	3,99	382	1.501	3,93
Gjakovë	1.048	4.347	4,15	1.036	4.268	4,12	1.010	4.141	4,10	1.001	4.085	4,08
Gllgovc	1.345	6.048	4,50	1.325	5.939	4,48	1.331	5.983	4,50	1.303	5.864	4,50
Gjilan	1.119	4.616	4,13	1.117	4.599	4,12	1.098	4.507	4,10	1.130	4.653	4,12
Dragash	380	1.305	3,43	358	1.216	3,40	366	1.234	3,37	377	1.264	3,35
Istog	530	2.224	4,20	515	2.166	4,21	521	2.191	4,21	517	2.200	4,26
Kaçanik	795	3.416	4,30	804	3.435	4,27	808	3.448	4,27	801	3.442	4,30
Klinë	802	3.432	4,28	826	3.495	4,23	829	3.508	4,23	818	3.471	4,24
Fushë Kosovë	738	3.197	4,33	769	3.338	4,34	777	3.372	4,34	789	3.436	4,35
Kamenicë	642	2.445	3,81	648	2.463	3,80	652	2.476	3,80	655	2.489	3,80
Mitrovicë	1.997	8.373	4,19	2.063	8.611	4,17	2.098	8.742	4,17	2.098	8.717	4,15
Leposaviq	220	568	2,58	208	550	2,64	214	543	2,54	224	565	2,52
Lipjan	1.236	5.694	4,61	1.287	5.862	4,55	1.252	5.702	4,55	1.300	5.912	4,55
Novobërdë	388	1.357	3,50	431	1.471	3,41	445	1.517	3,41	454	1.545	3,40
Obiliq	763	3.146	4,12	814	3.332	4,09	830	3.411	4,11	856	3.497	4,09
Rahovec	768	3.218	4,19	745	3.115	4,18	712	2.969	4,17	717	2.993	4,17
Pejë	1.112	4.428	3,98	1.112	4.400	3,96	1.074	4.254	3,96	1.060	4.248	4,01
Podujevë	1.014	4.774	4,71	1.038	4.856	4,68	1.002	4.702	4,69	1.004	4.702	4,68
Prishtinë	1.590	6.238	3,92	1.654	6.450	3,90	1.666	6.497	3,90	1.664	6.474	3,89
Prizren	1.095	4.262	3,89	1.106	4.287	3,88	1.075	4.153	3,86	1.054	4.056	3,85
Skenderaj	891	4.239	4,76	824	3.856	4,68	824	3.855	4,68	852	3.986	4,68
Shtime	425	1.976	4,65	432	2.015	4,66	411	1.909	4,64	409	1.923	4,70
Shtërpcë	358	1.258	3,51	424	1.489	3,51	414	1.454	3,51	308	1.058	3,44
Suharekë	585	2.713	4,64	586	2.711	4,63	545	2.520	4,62	569	2.645	4,65
Ferizaj	969	4.114	4,25	1025	4.339	4,23	1.023	4.319	4,22	1042	4.366	4,19
Viti	637	2.867	4,50	612	2.711	4,43	635	2.807	4,42	604	2.661	4,41
Vushtri	1.389	6.038	4,35	1.483	6.462	4,36	1.472	6.398	4,35	1.435	6.254	4,36
Zubin Potok	354	793	2,24	374	867	2,32	401	922	2,30	410	957	2,33
Zveçan	245	620	2,53	252	627	2,49	276	700	2,54	279	707	2,53
Malishevë	765	3.764	4,92	747	3.669	4,91	725	3.542	4,89	737	3.606	4,89
Junik	104	397	3,82	96	371	3,86	91	336	3,69	91	333	3,66
Mamushë	22	72	3,27	25	88	3,52	20	73	3,65	21	78	3,71
Hani i Elezit	195	821	4,21	182	761	4,18	178	751	4,22	183	764	4,17
Graçanicë	121	450	3,72	137	502	3,66	128	457	3,57	132	486	3,68
Ranillug	110	287	2,61	165	449	2,72	185	502	2,71	198	542	2,74
Partesh	20	55	2,75	31	93	3,00	34	100	2,94	36	107	2,97
Kllokot	120	411	3,43	132	456	3,45	136	470	3,46	118	407	3,45
Mitrovicë Veriore	697	1.576	2,26	688	1.612	2,34	684	1.630	2,38	674	1.581	2,35
Gjithsej	26.067	107.502	4,12	26.551	108.892	4,18	26.345	107.701	4,09	26.302	107.575	4,09

Tabela 2 .Skema e ndihmës sociale 2015 / 2016

Viti	Familje	Anëtarë
2015	25,943	107,451
2016	26,302	107,575

Numri i familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale në vitin 2016 ishte 26,302. Krahasuar me vitin 2015 numri i familjeve që kanë përfituar nga kjo skemë ka shënuar rritje për 359 familje ose shprehur në përqindje 1.4%.

Grafikoni 1. Skema e ndihmës sociale 2015/ 2016




Tabela 3. Pensionet bazike të moshës sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3			TM4		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Deçan	1.161	2.370	3.531	1.160	2.379	3.539	1.045	2.221	3.266	1.082	2.246	3.328
Gjakovë	1.869	3.805	5.674	1.866	3.746	5.612	1.857	3.645	5.502	1.830	3.696	5.526
Glogovc	936	2.191	3.127	895	2.023	2.918	852	1.933	2.785	817	1.953	2.770
Gjilan	3.373	5.290	8.663	3.309	5.206	8.515	3.182	5.012	8.194	3.076	4.936	8.012
Dragash	1.513	2.622	4.135	1.576	2.670	4.246	1.579	2.698	4.277	1.589	2.743	4.332
Istog	1.573	2.357	3.930	1.544	2.325	3.869	1.524	2.261	3.785	1.545	2.295	3.840
Kaçanik	847	1.787	847	814	1.740	2.554	752	1.601	2.353	723	1.601	2.324
Klinë	1.356	2.019	3.375	1.292	1.907	3.199	1.212	1.845	3.057	1.158	1.778	2.936
Fushë Kosovë	509	1.256	1.765	496	1.183	1.679	419	1.134	1.553	372	1.088	1.460
Kamenicë	2.535	3.510	6.045	2.413	3.397	5.810	2.259	3.154	5.413	2.175	3.063	5.238
Mitrovicë	1.656	4.931	6.587	1.442	4.542	5.984	1.390	4.357	5.747	1.346	4.357	5.703
Leposaviq	1.742	1.942	3.684	1.373	1.551	2.924	1.394	1.568	2.962	1.446	1.616	3.062
Lipjan	1.813	3.272	5.085	1.800	3.204	5.004	1.680	2.976	4.656	1.591	2.926	4.517
Novobërdë	286	391	677	253	354	607	196	283	479	183	273	456
Obiliq	362	1037	1.399	361	1037	1.398	320	966	1.286	301	972	1.273
Rahovec	1.420	2.445	3.865	1.431	2.462	3.893	1.371	2.292	3.663	1.368	2.348	3.716
Pejë	2.340	4.988	7.328	2.355	5.042	7.397	2.230	4.777	7.007	2.270	4.880	7.150
Podujevë	1.792	4.153	5.945	1.785	4.089	5.874	1.718	3.963	5.681	1.681	4.021	5.702
Prishtinë	2.553	6.983	9.536	2.444	6.773	9.217	2.229	6.324	8.553	2.072	6.311	8.383
Prizren	3.298	6.709	10.007	3.227	6.559	9.786	3.221	6.491	9.712	3.183	6.514	9.697
Skenderaj	1.237	2.687	3.924	1.211	2.689	3.900	1.117	2.379	3.496	1.120	2.419	3.539
Shtime	666	1.095	1.761	688	1.151	1.839	629	1.033	1.662	672	1.128	1.800
Shtërpcë	1.046	1.146	2.192	1.040	1.122	2.162	1.021	1.087	2.108	966	1.045	2.011
Suharekë	1.597	2.975	4.572	1.561	2.934	4.495	1.504	2.848	4.352	1.447	2.804	4.251
Ferizaj	1.975	3.890	5.865	1.953	3.772	5.725	1.881	3.690	5.571	1.824	3.724	5.548
Viti	1.695	2.346	4.041	1.651	2.313	3.964	1.587	2.213	3.800	1.584	2.266	3.850
Vushtri	1.099	3.048	4.147	1.075	3.034	4.109	1.031	2.910	3.941	1.013	2.913	3.926
Zubin Potok	721	855	1.576	536	681	1.217	489	633	1.122	499	635	1.134
Zveçan	673	796	1.469	602	721	1.323	589	703	1.292	580	690	1.270
Malishevë	1.296	1.998	3.294	1.297	1.994	3.291	1.239	1.896	3.135	1.241	1.896	3.137
Junik	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Mamushë	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Graçanicë	51	109	160	46	100	146	43	88	131	37	89	126
Hani i Elezit	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Ranillug	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Partesh	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Kllokot	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Mitrovicë Veriore	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej	44.990	85.003	129.993	43.496	82.700	126.196	41.560	78.981	120.541	40.791	79.226	120.017

Grafikoni 2. Pensionet bazike të moshës sipas gjinisë




Tabela 4. Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit

Periudha	Shqiptarë	Të tjerë ⁶	Gjithsej
TM1	99,015	30,978	129,993
TM2	98,490	27,706	126,196
TM3	95,028	25,522	120,550
TM4	95,820	24,194	120,014

Grafikoni 3. Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit në përqindje




Tabela 5. Pensionet bazike të moshës në vitet 2015 / 2016

Periudha	V i t e t	
	2015	2016
TM1	126,212	129,993
TM2	128,190	126,196
TM3	130,320	120,541
TM4	132,000	120,017

Numri i personave që kanë përfituar nga pensioni bazik i moshës ishte 120,017. Krahasuar me vitin 2015, kemi një rënie për 11,983 ose shprehur në përqindje 9%.

⁶ Në të tjerët janë të përfshirë numri i serbëve dhe nacionaliteteve të tjera joshqiptare që jetojnë në Kosovë dhe që përfitojnë nga pensioni bazik i moshës

Grafikoni 4. Numri i përfituesve nga pensionet bazike të moshës në vitin 2015 / 2016




Tabela 6. Pensionet kontributpaguese të moshës sipas komunave

Komuna	TM1			TM2			TM3			TM4		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Deçan	700	71	771	727	78	805	694	72	766	725	76	801
Gjakovë	2.228	967	3.195	2.260	999	3.259	2.210	970	3.180	2.242	1.015	3.257
Glllogovc	1.025	27	1.052	1004	26	1.030	914	27	941	971	28	999
Gjilan	1.490	156	1.646	1.529	163	1.692	1.478	173	1.651	1.506	178	1.684
Dragash	637	29	666	639	30	669	634	30	664	648	33	681
